



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr 3165/2 prot

Gramsh 06.09.2023

V E N D I M

Nr 63 dt. 31.08.2023

PER MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PLANIT TË BUXHETIT TË BASHKISË
GRAMSH PËR VITIN 2023.

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës __.01.2023 , pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Për miratimin e ndryshimit të planit të buxhetit të Bashkisë Gramsh për vitin 2023”, mbështetur në ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 34-41, neni 54 shkronja dh”, në ligjin nr 68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore neni 6 dhe neni 45 i tij” në ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, neni 44”, në ligjin Nr.162/2020 ”Për prokurimin publik neni 127 i tij”, në VKM nr.285, datë19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public neni 107 I tij” në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.103 dt 27.12.2022 “ Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2023 të Bashkisë Gramsh”.

V E N D O S I

I.Të pakësohet fondi për zërat sa më poshtë.

Nr	Emërtimi i shpenzimit	Fondi i Planifikuar	Përdorimi	Pa Përdorur	Shuma që do të transferohet te programi 05110	Programi	Vërejtje
1	Mirëmbajtje e Njësive Administrative	3,100,000	0	3,100,000	1,864,000	01110	Të ardhurat e vitit

II. Të shtohen fondi për shpenzimet shtesë të kontratës Nr.3946 datë 15.10.2020 “Për shërbimin e pastrimit dhe transportit të mbeturinave, të gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dekori i qytetit të Gramshit” si më poshtë

Nr	Emërtimi i shpenzimit	Vlera e shpenzimeve 2023-2025	Shuma që do të financohet për vitin 2023	Programi	Burimi i financimit
1	Shpenzime për shërbimin e pastrimit, gjelbërimit, transportit e mbeturinave dhe mirëmbajtjes së varrezave publike	6,311,000	1,864,000	05100	Të ardhurat e vitit
Nr	Emërtimi i shpenzimit	Vlera e shpenzimeve 2023-2025	Shuma që do të financohet për vitin 2024	Programi	Burimi i financimit
1	Shpenzime për shërbimin e pastrimit, gjelbërimit, transportit e mbeturinave dhe mirëmbajtjes së varrezave publike	6,311,000	2,480,000	05100	Të ardhurat e vitit
Nr	Emërtimi i shpenzimit	Vlera e shpenzimeve 2023-2025	Shuma që do të financohet për vitin 2025	Programi	Burimi i financimit
1	Shpenzime për shërbimin e pastrimit, gjelbërimit, transportit e mbeturinave dhe mirëmbajtjes së varrezave publike	6,311,000	1,967,000	05100	Të ardhurat e vitit

III. Për të financuar shpenzimet shtesë për shpenzime për shërbimin e pastrimit, gjelbërimit, transportit e mbeturinave dhe mirëmbajtjes së varrezave publike për periudhën 2024 në vlerën 2,480,000 (dy million e katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë dhe për periudhën 2025 në vlerën 1,967,000 (një million e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të merren masat që kërkohen të parashikohen gjatë hartimit të programit buxhetor për vitet respektive.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Enis Zani



Konc. Dakt. Xh. Gjini
Miratoi. E. Zani
Konfirmoi. E. Zani
Dosja _____
Afati _____